

URDHËR
Nr. 174, datë 16.5.2022

**PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, të ndryshuar,

URDHËROJ

1. Ngarkimin e znj. Daniel Pirushi për ushtrimin e detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), krahas ushtrimit të detyrës aktuale të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe zhvillimit të mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Znj. Pirushi do të ushtrojë detyrat shtesë të drejtorit të përgjithshëm të AKZM-së, duke filluar nga data 17.5.2022, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi